



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE GJILAN**

---

Numri i lëndës: 2018:009980

Datë: 06.04.2018

Numri i dokumentit: 00022857

P. nr.1132/2016

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN** - Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me praktikantin Lirak Musliu, në lëndën penale kundër të akuzuarve B. e Sh.Sh. nga Gjilani, për veprën penale, Sulmi, nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II. nr. 1619/16, të datës 19.09.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 04.04.2018, bie dhe në prezencë të palëve mori dhe publikoi, ndërsa më 06.04.2018 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **B.Sh.**, nga babai S. dhe nëna I., e lindur B., i lindur më datë ... në Prishtinë, jeton, në Gjilan, rr. “ ... ” nr. ... i pa martuar, i pa punë, ka të kryer shkollëne mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij

I akuzuari **Sh.Sh.**, nga babai S. dhe nëna I., e lindur B., i lindur më datë ... në Gjilan, ku edhe jeton, në rr. “ ... ” i pa martuar, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij

**J A N Ë F A J T O R Ë**

**I.** I akuzuari **B.Sh.**, sepse, më datë 19.08.2016, rreth orës 23.00, në shtëpinë e tyre në Gjilan, ka ushtruar dhunën familje, në atë mënyrë që derisa i akuzuari Sh. e kishte pyetur se ku janë zmadhuesit e zërit, i është përgjegjur se nuk i intereson se ku janë, me ç’rast, kishin filluar mosmarrëveshjet mes tyre, e pastaj, kishte ardhur deri te kontakti fizik, me ç’rast1, e ka përdorë forcën dhe e ka goditur të dëmtuarin Sh. nëpër pjesë të ndryshme të trupit, për çka, pastaj, pasi ka ndërhyrë motra e tyre, tani e dëmtuara Sh. për t’i ndarë, i akuzuari B. e ka përdorë forcën dhe e ka sulmuar edhe atë, duke e goditur me shuplakë në fytyrë dhe grusht në bark,

-me çka ka kryer veprën penale **Sulmi**, nga **neni 187, par. 1 të KPRK-së**,

**II.** I akuzuari **Sh.Sh.**, sepse, në ditën, vendin dhe kohën si nëë dispozitivin I të kësaj aktakuze, pas fjalosjes që kishte ndodhur në mes tij dhe të dëmtuarit-të akuzuarit B., duke e përdorë forcën, me dashje ka sulmuar ate, duke e kapur për fytyrë goditur nëpër pjesë të ndryshme të trupit, derisa kishin ndërhyrë për t’i ndarë babai S. dhe motra Sh.,

-me çka ka kryer veprën penale **Sulmi**, nga **neni 187, par. 1 të KPRK-së**, andaj, Gjykata, në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 51, 73, 114 të KPRK-së dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së,

## **I G J Y K O N** **ME DËNIM ME KUSHT**

**I.** Të akuzuarin **B.Sh.**, me **Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej **1 (një) viti** nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

**II.** Të akuzuarin **Sh.Sh.**, me **Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej **1 (një) viti** nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

**Obligohen** të dy të akuzuarit që ta paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej **15 (pesëmbdhjetë) €**, secili veç e veç, si dhe shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, **udhëzohet në kontest juridiko-civil**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP. II. nr. 1619/2016, të datës 19.09.2016, kundër të akuzuarve B. e Sh.Sh., për shkak të veprës penale Sulmi, nga neni 187, par. 1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe të dënohen me dënim meritor sipas ligjit.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datë 05.04.2018, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit Rozelida Manastiri, të akuzuarit B. e Sh.Sh., kanë deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen, duke deklaruar se e pranojnë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, pas dëgjimit të palëve, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, ngase ka ardhur në përfundim se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë të parapara në nenin 248 paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të gjyqtarës së vetme gjykuese, i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat janë paraqitur së bashku me aktakuzë dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPPK-së.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, erdhi në përfundim se të akuzuarit B. e Sh.Sh., kanë kryer veprën penale Sulmi, nga neni 187 par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit dhe llojin e lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se të akuzuarit patën sjellje korrekte në Gjykatë, se janë penduar për veprën në fjalë, ndërsa, si rrethanë rënduese, mori shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.  
Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2018:009980, 06.04.2018**

*P.nr. 1132/16*

**G j y q t a r i**

Luljete Shabani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.